

ABSTRAKTI

Qëllimi i trajtimit të kësaj teme është identifikimi i arsyeve dhe rolit që ka Kryeministri në sistemin kushtetues të Kosovës, dhe ndikimit të tij në politikën shtetërore dhe jashtë vendit.

Shkak për përzgjedhjen e kësaj teme është përshkrimi më në detaje i pozitës së kryeministrit në sistemin kushtetues të Kosovës dhe trajtimi më në gjërsi i rolit dhe funksionit të tij.

Qeveria ka funksionin ekzekutiv në Kosovë dhe ushtron pushtetin në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin, nën udhëheqjen e Kryeministrit, faktor ky që e bën shumë të rëndësishëm rolin e tij.

Shtetformimi është në lidhje të ngushtë me faktorin Kryeminister dhe elaborimi i pozitës dhe funksionit të tij ka rëndësi të veçantë.

Punimi është ndarë në katër kapituj, ku në secilin kapitull trajtohet dhe përshkruhet pozita kushtetuese e Kryeministrit.

Strukturimi i temës është bërë duke filluar nga objektivat, qëllimi dhe metodologjia, historiku i rolit të Kryeministrit duke vazhduar më tej me aspektin historik të zgjedhjes së Qeverisë në Kosovë, relacioni i Kryeministrit me Presidentin si dhe sistemi politik në Kosovë.

Janë shtjelluar procedurat e zgjedhjes, dorëheqjes, votimi i mosbesimit si dhe kompetencat e Kryeministrit, janë cekur edhe raste që lidhen me pozitën e Kryeministrit në aspektin kushtetues siç është mandatimi i z.Hoti për Kryeminister dhe aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për votën e Etem Arifit, duke e përmbyllur me anketën e përberë nga pyetje lidhur me Kryeministrin.

Fjalët Kyçe: Roli i Kryeministrit, Pushteti Qendror, Kushtetuta e Kosovës.